



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec



Opština Skupština Rahovac / Municipality of Rahovec



REPUBLIKA KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS / SKUPŠTINA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY



RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 34/22 Nr. i faq./Br.etr./No.pg

Data/Datum/Date 29 / 06 / 2022

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013"), nenit 25 dhe nenit 26 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019"), nenit 29 dhe nenit 32 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.06.2022 merr këtë:

V E N D I M

Për këmbimin e pronës komunale me pronën e institucionit qendror

1. **Miratohet** propozimi Kryetarit të Komunës Nr. 02/2251/22 i datës 09.06.2022 dhe jepet PËLQIMI për këmbimin e pronës publike komunale me pronën e institucionit qendror për interes publik, e cila gjendet në vendin e quajtur Rezine zonë kadastrale Pastasellë, ngastra me numër P-71510066-00944-0 sipas Certifikatës së pronësisë pronë e Komuna e Rahovecit, me sipërfaqe prej 1000m² (njëmijë metra katror) e cila ndahet nga pjesa e përgjithshme prej 3321m² (tremijë e treqind e njëzet e një metra katror) I JEPET Ekonomisë së Pyjeve, ndërsa ngastra sipas Certifikatës së pronësisë P-71510066-00386-1 në emër të Pasuri Shtetërore e Kosovës K.K.Rahovec, Shfrytëzues Ekonomia e Pyjeve Rahovec me sipërfaqe të përgjithshme prej 22005m² (njëzet e dy mijë e pesë metra katror) i miret pjesa e parcelës me sipërfaqe prej 1000m² (njëmijë metra katror) dhe I JEPET Komunës së Rahovecit, në emër të këmbimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për aktivitetet kulturore-sportive për nevojat e komunitetit të fshatit Pastasellë.
2. Qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e Ekonomisë së Pyjeve të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është për interes publik, përkatësisht për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për aktivitetet kulturore-sportive për nevojat e komunitetit të fshatit Pastasellë dhe se në të njëjtin vend nuk ekzistojnë parcela tjera komunale të përshtatshme për këtë qëllim.
3. Parcela me Nr. P-71510066-386-1 në të cilën parashihet ndërtimi i objektit sipas pikës 2 të këtij vendimi sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013 gjendet brenda Zonës Ndërtimore.

4. OBLIGOHET, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që ti zhvilloj procedurat ligjore në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
5. Vlerësimi i pronës komunale dhe pronës së Ekonomisë së Pyjeve të cekur në pikën 1 të këtij vendimi bëhet në bazë të ligjit përkatës për pronën e paluajtshme.
6. Pas përfundimit të procedurave për këmbim, rezultatet e këmbimit duhet publikuar, me përmbajtjen e të dhënave të pronave të këmbyerë, si dhe emrin e pronarit të institucionit me të cilin është bërë këmbimi.
7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Kuvendit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr-342/22
Me datë 29.06.2022

